



02/Nr. 8009 /2018

Data: 19.09.2018

## PROCESVERBAL I KKSb-së

Nga mbledhja e tetë - VIII- për vitin 2018 mbajtur me datë: 31.08.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Nuhi Dema** (përfaqësues i stacionit policor), **Afrim Mustafa** (përfaqësues i policisë kufitare -vija e gjelbërt), **Sear Dernjani** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Ali Vishi** (përfaqësues i FSK-së), **Hyriete Isufi** (kryesuese e komitetit për komunitete), **Muhamed Suma** (përfaqësues i këshillit të bashkësisë islame në Han të Elezit), **Kujtim Dernjani** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Qamil Kalisi** (përfaqësues i Hendikosit).

Takimin e kryesoj kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Të ndryshme.

**Rufki Suma** pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Rufki Suma** a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

**Rufki Suma** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nuhi Dema** gjatë këtij muaji kemi pas 10 (dhjetë) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

**Afrim Mustafa** gjatë këtij muaji kemi pas 3 (tre) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

**Muhamed Suma** ditën e hënë fillon viti shkollorë dhe kërkojë nga policia të jenë shumë më aktiv për shkak se zhvillimi i punimeve nga kompania "Bektelenka" e ka ngarkuar rrugën kryesore që shkon në drejtim të shkollës.

**Nuhi Dema** plani i veprimit për muajin shtatorë komplet është i paraparë vetëm për shkollat duke filluar prej patrullimit në këmbë dhe pikave të kontrollit në afërsi të shkollave. Me përfaqësuesit e kompanisë “Bektelenka” kam biseduar për rrugën e fshatit Paldenicë për këmbësorë dhe kanë premtuar që do ta bëjnë një rrugë më të veçantë për këmbësorë. Do të ketë ligjërata nëpër shkolla dhe kontakte më të shpeshta me drejtorit .

**Amir Bushi** rruga nga shkolla e mesme “Dardania” që shkon në drejtim të shkollës fillore duhet të pastrohet sepse lëvizja e nxënësve është më e madhe për shkak të fillimit të vitit shkollorë.

**Rufki Suma** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

### 3. Të ndryshme.

**Rufki Suma** policia duhet të ju kushton rëndësi zhvillimit të punimeve të kompanisë “Bektelenka” por edhe ne kemi disa problem për shkak se edhe Ministria e Infrastrukturës edhe përfaqësuesit kompanisë “Bektelenka” janë zotuar se kanë me rregulluar rrugën Dheu i Bardh-Paldenicë. Banorët kanë protestuar për këtë çështje dhe përfaqësuesit e Ministrisë kanë potencuar se rruga do të bëhet e kalueshme. Për ditën e hënë i kam ftuar në takim përfaqësuesit e Bektelenkës për me biseduar për këtë çështje dhe nëse nuk e kryejnë do të detyrohemi me dal me i bllokuar punimet e kompanisë “Bektelenka” në tërësi në territorin e komunës por paraprakisht do t’i njoftojmë me shkrim organet përkatëse. Nga punimet që i ka bërë kompania “Bektelenka” përveç dëmeve që ka bërë në infrastrukturë ka bërë edhe degradim të ambientit. Do të bëhet rregullimi i pushtave të dëmtuara. Do të rregullohet një pjesë e asfaltit të dëmtuar në rrugën Hani i Elezit -Gorancë , kurse pjesa tjetër që është do të rregullohet nga Ministria e Infrastrukturës. Shumica e rrugëve të cilët shkojnë deri te varrezat nëpër fshatrat e Hanit e Elezit në këtë vit do të përfundojnë. Në këtë vit kemi edhe një projekt për shpimin e puseve të ujit nëpër disa fshatra. Për shkak të punimeve të kompanisë “Bektelenka” nuk ka filluar me u realizuar projekti i trotuarit Hani i Elezit – Uji i Thartë. Projekti për vendosjen e kamerave ka filluar dhe pikat për vendosje të kamerave janë përcaktuar në bashkëpunim me policinë. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

**Amir Bushi** gjatë vizitave dhe këshillimeve familjare që kemi bërë vazhdimisht në familjen e z.Hamdi Topojani kemi vërejtur se gjatë zhvillimeve të punimeve nga kompania “Bektelekna” është dëmtuar shtëpia por fatmirësisht në ato momente nuk ka qenë asnjë fëmijë aty. Me përfaqësuesit e kompanisë “Bektelenka” kam biseduar që me ju bërë ndonjë zgjidhje për atë familje.

**Rufki Suma** duhet të bisedoni urgjentisht me përfaqësuesit e kompanisë që me i vendosë me ndonjë banesë apo shtëpi me qira dhe nëse nuk ua paguan qiranë kompania “Bektelenka” e paguan Komuna por vetëm mos të mbetet në rrezik ajo familje. Si qendër për punë sociale duhet të ndërmjetësoni urgjentisht në këtë çështje.

**Nuhi Dema** gjatë tërë muajit gushtë kemi pas probleme me autostradën që është duke u ndërtuar në fshatin Paldenicë dhe qytetarët orientohen në polici për dëmet që ua shkakton kompania në fjalë. A do të kishte mundësi që me zhvilluar biseda me Qeverinë për këtë çështje për shkak se si polici nuk mundemi me bërë zgjidhje sepse qytetarët duhet të shkojnë në mënyrë private në gjykatë.


**Rufki Suma** është mirë që të orientohen në komunë dhe komuna bënë përshkrimin e rastit së bashku me foto dhe inxhizime dhe i orienton në organet përkatëse.

**Muhamed Suma** kompania ka shkaktuar dëme edhe në fshatin Dimcë dhe si fshatë nuk kemi bërë probleme por kemi kërkuar me hap një rrugë alternative dhe kanë premtuar. Kompletë banorët i kanë dhënë nëshkrimet për hapjen e asaj rruge dhe kemi parashtruar në komunë kërkesë së bashku me projektin ideorë. Deri më tani asnjë përgjigje nuk kemi marr për këtë çështje. Komuna brenda mundësive që ka është mirë që të na ndihmon.

**Rufki Suma** premtime kanë dhënë por konkrete nuk ka asgjë dhe të gjitha kërkesat të cilat qytetarët i kanë dërguar në komunë i kemi dërguar me shkrim kompanisë dhe kemi kërkuar me shkrim me na u përgjigjur. A keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 50 ju faleminderit për pjesëmarrje.

**Procesmbajtësi**  
**Ayni Bushi**



**Kryetari i Komunës**  
**Rufki Suma**

